

Prof.Asoc.Dr. Arjan Qefalia

Arjan Qefalia me titull akademik 'Profesor i Asocuar' (që nga Maj 2015) është i punësuar me kohë të plotë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FEUT) nga Tetor 2005 deri më tani.

Ka një përvojë pune 18 vjeçare si pedagog (fillimisht i jashtëm, më pas me kohë të plotë) dhe studiues. Në periudhën 1998-2002 ka kryer studimet universitare në degën Administrim Biznesi dhe në vitet 2004-2006 studimet Master në Administrim Biznesi (MBA) në FEUT, më pas kryer studimet doktorale që lidhen me fushën e përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë publik shqiptar (fituar gradën 'Doktor' në FEUT në vitin 2010), kurse në vitin 2011 fituar titullin shkencor 'Docent'.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Menaxhimin e Cilësisë, Menaxhimin e Operacioneve, Menaxhimin e Biznesit dhe Menaxhimin e Zinxhirit të Furnizimit.

Në periudha të ndryshme ka shërbyer dhe shërben si anëtar i zgjedhur në organe kolegjiale, konkretisht: Mars 2012 - Prill 2016, anëtar i Këshillit të FE, UT; 27 Shkurt 2019 - Mars 2021, anëtar i Komisionit të Përhershëm të dhënies së gradës shkencore 'Doktor' pranë FEUT; 09 Shtator 2020 - e në vazhdim, anëtar i Senatit Akademik, UT (organi kolegjial më i lartë akademik i UT; me mandat 4-vjeçar); si dhe në periudha të ndryshme, sipas nevojave, shërbyer si ekspert i jashtëm akreditimi në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, apo si anëtar i jashtëm i Komitetit të Përhershëm të Pranimit dhe Ngritjes në Detyrë pranë Departamentit të Administratës Publike.

Ka marrë pjesë me punime shkencore (me mbi 25 të tilla si autor i vetëm dhe me bashkëpunëtorë) të paraqitura në konferenca dhe revista shkencore të njohura të organizuara kryesisht nga universitete në SHBA, Itali, Poloni, Shqipëri, Rumani, etj, si dhe ka qenë i përfshirë në projekte të ndryshme, dhe aktivitete të lidhura me kërkimin shkencor.